



**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR
NË LIDHJE ME KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE
(KAB) 2027-2029 – GORANCË**

Procesverbali nga dëgjimi i tretë buxhetor në lidhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027 - 2029 u zhvillua me datën **02.06.2026** duke filluar nga ora 14:30 në SHFMU “Veli Ballazhi” në fshatin Gorancë, në të cilin ishin gjithsej 14 pjesëmarrës, prej të cilëve 3 ishin gra dhe 11 burra. Dëgjimin buxhetor e kryesoi Shefja e Kabinetit të Kryetarit znjsh.Liridona Ballazhi e cila i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrjen e tyre, ku për rend të ditës kishin:

- 1. Prezentimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029**
- 2. Diskutimi i hapur**

Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029 e prezantoi Drejtorja për Buxhet dhe Financa, znj.Lindita Ballazhi.

1. Prezentimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore

Lindita Ballazhi: Duke u bazuar në Ligjin për Financa Publike dhe Përgjegjësitë, Qeveria e Kosovës gjatë muajit maj të këtij viti ka aprovuar Kornizën Afatmesme të shpenzimeve qeveritare apo KASH-in për periudhën 2027-2029, ku në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore të shpenzimeve qeveritare lëshoi Qarkorja e parë buxhetore dhe me kufijtë fillestarë në nivel të Kosovës. Me pranimin e Qarkores së parë buxhetore, kemi kufijtë fillestarë buxhetore me të cilat ne bëjmë planifikimin e buxhetit për vitin vijues apo konkretisht për vitin 2027, si dhe parashikimet e hershme për vitin 2028-2029, me ç'rast ne bëjmë hartimin e shpenzimeve duke renditur prioritetet kryesore komunale dhe normalisht objektivat të cilat janë të identifikuar në dokumente strategjike komunale. Fazat për zhvillimin e KAB-it komunal dhe afatet kohore janë: në maj Pranimi i Qarkores fillestare Buxhetore 01/2027, Draftimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029, në qershor Konsultimet me Asamblenë Komunale, Mbajtja e Debateve Buxhetore dhe Aprovimi i KAB-it në KPF dhe Kuvend Komunal deri me 30 qershor.

Për vitin buxhetor 2027 Buxheti i Komunës do të jetë 4,564,793.00 €, Ndërkaq tani presim projekt propozimet tuaja për vitin buxhetor 2027.

2. Diskutimi i hapur

Shefket Lusnjani: Përshëndetje për të gjithë. I kemi disa kërkesa nga Këshilli i fshatit Gorancë:

1. Hapja e rrugës bypass Hani i Elezit – Gllloboçicë (Fushë – varrezat e fshatit),
2. Asfaltimi i rrugës për tek pllakata e dëshmorëve Feriz dhe Xhevdet Guri duke filluar nga varrezat, përroi, Sudonec deri tek pllakata, gjithashtu të vazhdohet rruga nga “Molla e Osmanit” deri tek përroi,
3. Shtrimi i kubëzave brenda varrezave të fshatit Gorancë,
4. Lidhja e tensionit të lartë të rrymës që shkon në fabrikë për tek pompa e ujit në Sudonec si dhe shpenzimet e pompës të barten në Komunë,
5. Kërkesat nga këshilli i fshatit për ndihmë me të holla 1,000.00€ apo 500.00 €,
6. Kërkesë për vendosjen e shprotave të mbeturinave Brenda fshatit,
7. Kapakët e shakteve prej varrezave, nëpër fshat edhe kanalizimi deri tek fshati Rezhancë,
8. Rregullimi i asfaltit dhe vendosja e pengesave të shtrira nëpër fshat,
9. Rregullimi i shëtitores Gorancë-Pisha-Hunel, shtrimi i kubëzave, ndriçimi, vendosjen e ulëseve dhe shtegun për biciklista,
10. Mirëmbajtja e parkut të ambulances, parkut te pishat,
11. Ndërrimi i shtyllave të drurit me ato të betonit dhe ndërrimin e rrjetit prej teli në kablo në rrugën “Pavarësia”,
12. Shtrimi i asfaltit nga Lagja Huneli deri tek Pishat,
13. Rregullimi i rrugës dhe pishinës publike tek vendi “Gjurra”,
14. Rregullimi i transportit publik për nxënësit e Shkollës Filllore dhe të Mesme.

Lindita Ballazhi: Ne kemi mbajtur procesverbal të këtij debati dhe të gjitha propozime tuaja do të shqyrtohen sërish. Nëse dikush ka ndonjë pyetje tjetër apo propozim, mundeni edhe të më drejtorheni në emailin tim Lindita.ballazhi@rks-gov.net apo edhe kërkesat tuaja ti dërgoni fizikisht tek Qendra për Shërbim me Qytetarë, e më pas ne do t'i shqyrtojmë të gjitha kërkesat, sugjerimet,

rekomandimet dhe propozimet tuaja, si ato gjatë këtij dëgjimi, ashtu edhe ato përmes emailit dhe përmes dërgimit të QSHQ. Nëse nuk ka tjetër diskutim apo propozim, e konsideroj të mbyllur dëgjimin buxhetor.

Debati publik përfundoi në orën 15:15.

Procesmbajtës
Lindita Balazhi

